

**V E N D I M**  
**Nr.4, datë 7.1.1999**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.643, DATË  
18.10.1998 ‘PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENCAT E  
KONVIKTEVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE PËR NXËNËSIT  
DHE STUDENTËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

1.Kuota financiare ushqimore për studentët, e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.643, datë 18.10.1998, rritet në masën 10 për qind nga data 1.1.1999 deri më 31.3.1999.

Nga data 1.4.1999, deri më 31.12.1999 kuota financiare ushqimore rritet edhe 10 për qind mbi kuotën e përcaktuar në vendimin e sipërpërmendur.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga ky vendim përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 1999 për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

**K R Y E M I N I S T R I**  
**Pandeli Majko**